



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Nika Pro Ing Sh.P.K.” të datës 23.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i shkollave dhe IEA-së - Gëlqerosja” me nr. të prokurimit 616-25-5454-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Nika Pro Ing Sh.P.K.” të datës 23.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i shkollave dhe IEA-së - Gëlqerosja” me nr. të prokurimit 616-25-5454-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Nika Pro Ing Sh.P.K.” (tutje “parashtruesi”) me datë 23.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i shkollave dhe IEA-së - Gëlqerosja” me nr. të prokurimit 616-25-5454-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimi 1 – Mospërbushja e kriterëve teknike dhe profesionale (Kërkesa 3)

Sipas kërkesës nr. 3 të Dosjes së Tenderit, Operatorët Ekonomik duhet të dëshmojnë se kanë në resurset e tyre njerëzore minimumi 15 punonjës teknikë, nga të cilët minimumi 10 të jenë të certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë, me dokumentacionin përkatës që përfshin:

Lista e nënshkruar dhe e vulosur e punëtorëve;

Diplomat e shkollave të mesme profesionale për teknikët;

Certifikatat e trajnimeve dhe

Min për 10 prej Punëtorëve Teknik me përgatitje të mesme shkollore dhe Punëtor të certifikuar duhet të dorëzohen kopjet Certifikatave për Siguri dhe Shëndet në punë

Konstatimi ynë:

1. **Tekniku murator – z. O.M.:** Certifikata e paraqitur nga OE nuk është lëshuar nga trupë certifikuese e akredituar. Verifikimi i bërë nga ne në sistemin e ofruar nga kompania certifikuese ka treguar qartë se certifikata nuk është e qasshme dhe nuk figuron në databazën zyrtare të kësaj kompanie. (ndryshe nga certifikata tjera që lehtë verifikohen nga e njëjta kompani e certifikimit)
2. **Operator në vinq – z. E.M.:** Po ashtu, certifikata e këtij punëtori nuk rezultoi të jetë nga institucion i akredituar, dhe është e pavlefshme për qëllimet e përmbushjes së kriterëve teknike të përcaktuara nga AK. Certifikata nuk verifikohet përmes sistemit të kompanisë certifikuese. (ndryshe nga certifikata tjera që lehtë verifikohen nga e njëjta kompani e certifikimit)

Dëshmitë e verifikimit online (screenshot-e dhe lidhjet zyrtare të kompanive certifikuese) janë bashkangjitur kësaj ankese për të mbështetur pretendimet tona.

Pretendimi 2 – Mungesa e kranistit në dokumentacion

Sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues, është kërkuar qartë që në kuadër të stafit teknik të jenë të përfshirë, ndër të tjerë, edhe:

- Një kranist i certifikuar

Konstatimi ynë:

Në listën e stafit teknik të prezantuar nga GOE i shpërblyer nuk figuron asnjë person i identifikuar si kranist.

Gjatë shqyrtimit të certifikatave të dorëzuara, nuk ekziston asnjë certifikatë për profesionin e kranistit.

Pra, përveç certifikatave të pavlefshme për disa punonjës, GOE i shpërblyer nuk ka përmbushur kërkesën elementare për përfshirjen e një kranisti të certifikuar, siç kërkohej në FTD.

Pretendimi – Paga e prezantuar për njerin nga Ing. e paraqitur.

Aktualisht (që nga 1 tetori 2024), paga minimale në Kosovë është 350 € bruto në muaj për të gjithë punonjësit, drejtuesi i ri ligjor që shfuqizon tarifën e mëparshme sipas moshës.

Bazuar në Ligjin për Pagën Minimale në Republikën e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2024, është përcaktuar që paga minimale bruto mujore është 350 (treqind e pesëdhjetë) euro për të gjithë punonjësit, pa dallim moshe, statusi apo forme të kontratës. Ky ligj ka shfuqizuar të gjitha kategorizimet e mëhershme të pagave sipas moshës apo kushteve të tjera të veçanta.

Në këtë kontekst, paraqesim pretendimin në lidhje me kontratën e paraqitur nga GOE për pozitën e Inxhinierit të Ndërtimitarisë – drejtimi Konstruktiv, z. R.Z., i cili është propozuar me kontratë të rregullt me afat të përcaktuar. Kontrata është:

- Nënshkruar në datë 03.01.2025
- E vlefshme deri në datë 31.12.2025

Sipas përmbajtjes së nenit 7 të kësaj kontrate:

Palët janë dakorduar që z. R.Z. të punojë me orar të plotë, përkatësisht nga ora 08:00 deri në ora 16:00, çka përbën një angazhim me kohë të plotë sipas definicionit të legjislacionit të punës në fuqi.

Ndërsa, në nenin 8 të së njëjtës kontratë:

Është përcaktuar paga mujore, e cila rezulton të jetë nën kufirin e pagës minimale të përcaktuar me ligj (350 € bruto), dhe për rrjedhojë është në kundërshtim me Ligjin për Pagën Minimale në Republikën e Kosovës.

Ky dispozitiv bie në kundërshtim me:

- Nenin 4 të Ligjit për Pagën Minimale, që përcakton vlerën minimale të obligueshme për të gjithë punëdhënësit dhe punonjësit me orar të plotë;
- Si dhe Nenin 6, që ndalon në mënyrë eksplicite vendosjen e pagave më të ulëta se minimumi i përcaktuar, pavarësisht nga marrëveshjet kontraktuale midis palëve.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur që oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT duke përfshirë edhe kërkesat për stafin përkatësisht për kranistin teknikun murator, kranistin, operatorin me vinc dhe stafin tjetër. Në këtë mënyrë është gjetur se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme ndërsa të gjitha pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 28.07.2025



Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.